

Manual për shpërndarësit: Se si nëpërmjet UPS-ë të kthehet bërthama/pjesa Reman në WABCO

Për të rimarrë shumën e blerë për pjesët WABCO, duhet që bërthamën (= pjesën e përdorur) ta ktheni në WABCO.

- Bërthama/pjesa duhet të jetë në gjendje të konsumuar normale dhe në paketim origjinal (për të shmangur dëmtimin në tranzit).
- Bërthama mund të kthehet maksimumi një viti pas blerjes së pajisjes Reman.
- Shuma nuk do të rimburohet në qoftë se bërthama është keqpërdorur ose dëmtuar në mënyrë të pazakontë.
- Në paketimin origjinal paketon vetëm një bërthamë TEBS D.
- Etiketa e gjelbër (e treguar më poshtë) duhet të plotësohet në mënyrën e duhur.
- Etiketa e gjelbër duhet të jetë qartë e dukshme në kutinë në të cilën kthehet bërthama/pjesa.
- Përpunimi i paketave që kthehen pa etiketën e gjelbër mund të zgjasë më tepër.
- Rimbursimi i shumave do të përpunohet në përgjithësi brenda 2 javësh pasi ju dërgoni bërthamën/pjesën.



Nuk do të pranojmë pjesë të cilat janë të dëmtuara për shkak të mënyrës jo korrekte të përdorimit ose gjatë ç'montimit (dëmtime mekanike të lindura në mbulesë, në hapjet apo lidhjet)

Përshkrimi i procesit për shpërndarësit

1. Njoftoni klientët e puntorisë tuaj të cilët duhet të ndjekin procedurën e renditur me poshtë pasi marrin prej jush pajisjen në paketim origjinal WABCO REMAN.

Procesi për punëtoritë:

- a. Puntoria duhet të nxjerrë pajisjen e porositur WABCO REMAN nga paketimi origjinal.
- b. Puntoria duhet të vendosë bërthamën (= produktin e përdorur) në paketimin origjinal.
- c. Puntoria duhet të dërgojë/kthejë bërthamën/pjesën në përputhje me procedurën e mbledhjes së pjesëve të përdorura nga ana e distributorit, si shpërndarës i autorizuar i WABCO-s.
 - Në mënyrë që të thjeshtohet procesi i kthimit të pjesës së përdorur nga puntoria te distributori, puntoria duhet që në pikën 4 të etiketës në paketimin origjinal të shkruajë emrin e kompanisë së tij dhe adresën.


2. S Web faqja

http://www.wabco-auto.com/fileadmin/Reman_Templates/Doc_000044A_Form.pdf

Shkarko shabllonin/formularin për etiketën e gjelbër WABCO dhe ruajeni atë në serverin tuaj ose përdorni shabllonin që mund të gjeni në kutinë origjinale të kartonit. Këtë formular mund ta përdorni për të gjitha produktet TEBS që kthehen.

3. Plotësoni formularin (e shkarkuar nga Web faqja ose atë që ndodhet në kuti) dhe dërgojeni formularin e plotësuar në e-mail adresën: greenlabel@wabco-auto.com.
 - Kopjoni informacionin e marrë nga tesera/tabela e produktve WABCO prodhues (hapi 3).
 - Shënoni informacionin/të dhënat për kontakt (hapi 5).
 - Dërgojeni formularin e plotësuar në adresën e e-mail-it: greenlabel@wabco-auto.com.
4. Plotësoni etiketën në paketimin origjinal në të njëjtën mënyrë siç keni plotësuar formularin.
 - Nënshkruani etiketën (hapi 5), për qëllime dogane.
5. Ditën e nesërme do të vijë shoferi i UPS-ë për të marrë paketën dhe në të do të ngjisë edhe një etiketë shtesë UPS (vetëm me qëllim që të ndjekë rrugën e paketës).
6. UPS do të dorëzojë pakon në WABCO, e cila do të konsolidohet bashkë me pjesët e tjera të kthyera.
7. Pas inspektimit të pjesës /bërthamës së kthyer, një ekip vendor i shitjes WABCO, do të lëshojë një notë krediti.

Propozim



Naljepnica

